

VENDIM
Nr.726, datë 30.10.2003

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.511, DATË 24.10.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR KOHËZGJATJEN E PUNËS DHE TË PUSHIMIT NË
INSTITUCIONET SHTETËRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 19 shkronja "c", të nenit 20 shkronjat "ë" dhe "g" dhe të nenit 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe të neneve 76-108 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Shtetit për Integrimin European, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Pika 2 e kreut I të vendimit nr.511, datë 24.10.2002 të Këshillit të Ministrave të ndryshohet si më poshtë vijon:

"2. Orari ditor i punës të jetë si më poshtë vijon:

- Për periudhën 1 prill - 31 tetor fillon çdo ditë nga ora 8.⁰⁰ deri në orën 13.⁰⁰ dhe nga 14.³⁰ deri në orën 18.⁰⁰, ndërsa ditën e premte fillon në orën 8.⁰⁰ deri në orën 14.⁰⁰.

- Për periudhë 1 nëntor - 31 mars fillon çdo ditë në orën 8.⁰⁰ deri në orën 16.⁰⁰.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.11.2003, dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano